BASHKIA SARANDË SHPALL:

THIRRJEN PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN E PROJEKT-PROPOZIMEVE NË KUADRIN E ZBATIMIT TË PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, PLANIT TË BARAZISË GJINORE DHE INTEGRITETIT.

Bashkia Sarandë fton të gjitha Organizatat Lokale të Shoqërisë Civile (OSHC-të), që të paraqesin projekt-propozime që janë në përputhje me objektivat zhvillimor dhe prioritetet e Bashkisë si vijon:

1. **Arsimi Parauniversitar (2.000.000 Lekë)**

1.1 Kultura, Edukimi dhe Rinia – Aktivizimi i Qendrës Kulturore si hapësirë mendimi dhe zhvillimi

2. **Barazia Gjinore dhe Integriteti (1.500.000 Lekë)**

2.1 Fuqizimi i grave dhe vajzave në jetën publike dhe vendimmarrje. Promovimi i etikës, transparencës dhe integritetit në komunitet.

Shuma e fondeve për projektet e miratuara do të jetë 3.500.000 Lekë.

Bashkia rezervon të drejtën të mos i alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara. Kohëzgjatja e projektit duhet të zgjasë nga 4 deri në 6 muaj. Projektet e përzgjedhura do të zbatohen në periudhën nga muaji Korrik 2026 deri në muajin Dhjetor 2026.

PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha OShC-të e regjistruara zyrtarisht (shoqata/organizata apo fondacion) në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri. **Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të interesuara mund të gjejnë informacion të hollësishëm rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e**

projekteve në Udhëzimin për Aplikantë (Shtojca 6), pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.

DOKUMENTACIONI:
Dokumentacioni i aplikimit për thirrjen publike të **Bashkisë Sarandë** do të jetë i disponueshëm nga data **10.06.2026** pas dërgimit të një kërkese me e-mail në **adresën bashkiasarande@yahoo.com,** ku duhet të citoni emrin e organizatës së interesuar; ose duke u paraqitur personalisht në Bashkinë **Sarandë, zyra e projekteve, kati i tretë.** Të gjitha informacionet e nevojshme, si dhe një version elektronik i paketës së aplikimit mund të gjendet edhe në ëebsite zyrtare të Bashkisë Sarandë.

Pyetje rreth kësaj thirrje mund të bëhen përmes adresës **bashkiasarande@yahoo.com**, duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri më **22.06.2025,** ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse. Për qëllime transparence, përgjigjet do t'u dërgohen gjithashtu të gjithë aplikantëve të mundshëm, ose do të botohen në faqen e internetit të bashkisë.

DORËZIMI I APLIKIMEVE:

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohen **në tre (3) kopje fizike dhe një kopje elektronike (USB),** të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hëne – e premte), nga ora 09:00 deri ora 15:00, në adresat në vijim:

Bashkia Sarandë
Zyra e Protokollit
Adresa: Rruga "Abedin Dino"Nr.11

Afati për dorëzimin e aplikimeve është data **30 Qershor 2026 ora 16:00**. Aplikimet e dorëzuara në bashki pas këtij afati do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon se data dhe koha e dërgimit ka qenë para mbylljes së afatit zyrtar. Pjesa e jashtme e zarfit duhet të përmbajë **titullin e thirrjes për dorëzimin e propozimeve, emrin dhe adresën e plotë të kandidatit, emrin e plotë të projektit** dhe mbishkrimin "**Të mos hapet përpara hapjes zyrtare."** Formulari për regjistrimin e dokumentacionit të pranuar lëshohet nga përfaqësuesi i bashkisë. Të gjithë aplikantët që kanë paraqitur propozime, pavarësisht nëse pranohen ose jo, njoftohen me shkrim për vendimin e marrë për projekt-propozimin e tyre brenda 15 ditëve pune nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet do të publikohen në faqen e internetit të bashkisë dhe/ose në tabelën e njoftimeve të bashkisë.